



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 27 qershor 2022  
Nr. ref.:RK 2014/22

## AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI120/21

Parashtrues

**Brahim Lajqi**

**Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë  
së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës,  
Ac. nr. 5936/20, të 24 marsit 2021**

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzie Istrefi-Peci, gjyqtare dhe  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

#### Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Brahim Lajqi, nga fshati Zahaq, Komuna e Pejës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës). Parashtruesi i kërkesës përfaqësohet nga Xhevdet Krasniqi dhe Ilir Nikqi, avokatë nga Prishtina.

## **Vendimi i kontestuar**

- Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac. nr. 5936/20, të 24 marsit 2021, përmes të cilit është refuzuar ankesa e parashtruesit të kërkesës kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Ep. nr. 714/19, të 16 korrikut 2020.

## **Objekti i çështjes**

- Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimeve të Gjykatës së Apelit dhe asaj Themelore, përmes të cilave pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] paragrafi 2, nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), dhe nenet 7 dhe 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.

## **Baza juridike**

- Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

- Më 29 qershor 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
- Më 8 korrik 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban (anëtarë).
- Më 29 korrik 2021, Gjykata i njoftoi përfaqësuesit juridik të parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës, dhe ia dërgoi një kopje të kërkesës së regjistruar Gjykatës së Apelit.
- Më 8 qershor 2022, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

- Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se thelbi i kontestit ka të bëjë me çështjen e arkëtimit të borxhit për energjinë elektrike të shpenzuar në shumë prej 355.02 euro, i cili pretendohet se është krijuar nga parashtruesi i kërkesës për periudhën kohore nga data 3 prill 2014 deri më 10 tetor 2018.
- Më 19 nëntor 2018, Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike SH.A. (në tekstin e mëtejme: KESCO) i dorëzoi përmbaruesit privat propozimin për përmbarim kundër parashtruesit të kërkesës për shkak të arkëtimit të borxhit në shumë prej 355.02 euro, i cili është krijuar si rezultat i shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën kohore nga data 3 prill 2014 deri më 10 tetor 2018.

11. Më 22 nëntor 2018, përmbaruesi privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit (KESCO), lëshoi Urdhrin P. nr. 449/18, me të cilin e lejoi përmbarimin kundër parashtruesit të kërkesës.
12. Më 6 dhjetor 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti në Gjykatën Themelore prapësim ndaj urdhrin për përmbarim të përmbaruesit privat P. nr. 449/18, duke pretenduar se *"[...] borxhi i kërkuar nga kreditori ka arritur parashkrimin dhe si i tillë nuk ka të drejtë të realizoj që nga data 30.12.2013 e deri me datën 22.11.2017, pasi që borxhi për këtë periudhë është parashkruar sipas LMD-së, kurse borxhi i vetëm i cili nuk është parashkruar është pas datës 22.11.2017"*.
13. Më 16 korrik 2020, Gjykata Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm Civil (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) nxori Aktvendimin Ep. nr. 714/19, përmes të cilit e refuzoi si të pabazuar prapësimin e parashtruesit të kërkesës të paraqitur kundër propozimit për përmbarim të përmbaruesit privat P. nr. 449/18.
14. Në Aktvendimin Ep. nr. 714/19 të Gjykatës Themelore thuhet:

*"Pretendimet prapësi-more të palës debitore, të cilat konsistojnë në atë se në rastin konkret ka skaduar afati kohor brenda të cilit mund të kërkohej përmbarimi, duke theksuar se borxhi i kërkuar sipas dokumentit të besueshëm është i parashkruar, gjykata i refuzoi si të pabazuara ngase në rastin konkret duke ju referuar ekstraktit të verifikuar nga librat afarist për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave, për periudhën kohore nga data 03.04.2014 deri me datën 10.10.2018, është vërtetuar se debitori ka bërë pagesa të kohëpaskohshme dhe atë me datë 10.03.2014 në shumë prej 50 €, me datë 08.08.2014 në shumë prej 20 €, me datë 16.10.2014 në shumë prej 20 €, me datë 19.01.2015 në shumë prej 20 €, me datë 02.06.2015 në shumë prej 20 €, me datë 09.11.2015 në shumë prej 20 €, me datë 09.05.2016 në shumë prej 20 €, me datë 15.08.2016 në shumë prej 20 €, me datë 04.11.2016 në shumë prej 20 €, me datë 01.03.2017 në shumë prej 20 €, me datë 31.05.2017 në shumë prej 20 €, me datë 09.10.2017 në shumë prej 20 €, me datë 06.02.2018 në shumë prej 30 €, e në vazhdimësi deri të pagesa e fundit me datë 02.08.2018 në shumë prej 20 €, të cilat pagesa kanë ndikuar që të vijë deri të ndërprerja e parashkrimit dhe rrjedhimisht edhe pranimin e borxhit nga ana e debitorit.*

*Prandaj në këtë situatë gjykata nuk mund ti pranoj pretendimet e debitorit për aplikimin e nenit 360 par. 1 pika 1.1 dhe par. 2 të LMD-së (Ligji Nr. 04/L-077) i cili përcakton: se kërkesat të cilat parashkruhen pas një viti janë kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake, ndërsa afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë, për arsye se në rastin konkret me pagesën e bëra nga ana e debitorit dhe të fundit me datën 02.08.2018 ka ardhur deri të ndërprerja e parashkrimit, ngase propozimi i kreditorit për përmbarim është parashtruar më datë 21.11.2018 pa kaluar afati një vjeçar i përcaktuar me nenin 360 të LMD-së nga koha e fillimit të afatit të ri të parashkrimit, e duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 368 par. 1 të LMD-së i cili përcakton se: parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit, ndërsa me dispozitën ligjore të nenit 373 par. 6 të LMD-së është përcaktuar se: parashkrimi që fillon të rrjedhë përsëri pas ndërprerjes, mbaron kur të ketë kaluar aq kohë sa është caktuar me ligj për parashkrimin që është ndërprerë".*

15. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit ndaj Aktvendimit të Gjykatës Themelore Ep. nr. 714/19, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
16. Më 24 mars 2021, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin Ac. nr. 5936/20, me të cilin e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, ndërsa e vërtetoi në tërësi Aktvendimin e Gjykatës Themelore Ep. nr. 714/19.
17. Gjykata e Apelit në arsyetimin e Aktvendimit të saj theksoi se:

*"[...] Gjykata [...] vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit lidhur me gjendjen faktike si dhe ato për parashkrimin e borxhit, për faktin se sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit pasi që me dispozitën e nenit 360 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve Nr. 04/L-077 shprehimisht përcaktohet se: "Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: 1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimit e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevoja shtëpiake".*

*Me dispozitën e nenit 368 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve në mënyrë shprehimore parashihet se: "Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin", ndërsa me paragrafin 2 po të njëjtit ligj përcaktohet se: "Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit", në rastin konkret pala debitore ka bërë pagesa të kohëpaskohshme, si pagesa e datës 10.03.2014, në shumë prej 50.00 euro, pagesa e datës 19.01.2015, në shumë prej 20,00 euro, pagesa e datës 09.05.2016, në shumë prej 20,00 euro, pagesa e datës 01.03.2017, në shumë prej 20,00 euro, pagesa e datës 06.03.2018, në shumë prej 30.00 euro etj., duke vazhduar me pagesa tjera, e të cilat pagesa të bëra nga ana e debitorit e ndërpresin afatin e parashkrimit në kuptim të dispozitës së lartcekur dhe rrjedhimisht edhe pranimin e borxhit ndaj kreditorit, andaj qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë mbi refuzimin prapësimit të debitorit është i drejtë dhe i ligjshëm, ndërsa pretendimet ankimore të debitorit lidhur me parashkrimin e borxhit rezultojnë si pathemelta, të cilat kjo gjykatë i refuzoi si të pabazuara, ndërsa aktvendimin e atakuar vendosi që ta vërtetojë".*

18. Parashtruesi i kërkesës paraqiti para Prokurorisë së Shtetit propozimin për iniciimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, duke pretenduar se: *"[...] aktvendimi i Gjykatës Themelore Ep. nr. 714/19 datë 16.07.2020 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ac. nr. 5936 /20 datë 24.03.2021, janë nxjerr me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, zbatim të gabuar të së drejtës materiale (LMD-së) si dhe për shkak të vërtetimit të gabueshëm apo jo të plotë të gjendjes faktike..."*.
19. Më 18 maj 2021, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit lëshoi Njoftimin KMLC. nr. 39/2021, në të cilin e informoi parashtruesin e kërkesës se propozimi i tij nuk mund të aprovohet, *"[...] sepse pretendimet e cekura në propozimin tuaj nuk janë të mjaftueshme për paraqitjen e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë sipas nenit 247.1 pika a) dhe b) të Ligjit për Procedurën Kontestimore..."*.

## Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktvendimet e kontestuarra të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] paragrafi 2, nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës, me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe me nenet 7 dhe 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.
21. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk i shpjegon një nga një shkeljet e neneve të lartpërmendura të Kushtetutës, KEDNJ-së dhe Deklaratës Universale, por i shpjegon ato në disa paragrafë në këtë mënyrë:

*“[...] me vendimet e Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit me të cilët është refuzuar prapësimi dhe ankesa, i janë shkelur të drejtat në gjykim të drejtë dhe të pa anshëm, është cenuar parimi i sigurisë juridike si dhe është vendosur në mënyrë arbitrare, ngase gjykatat nuk kanë dhënë arsye të mjaftueshme dhe kanë bërë zbatim të gabuar si dhe interpretim të gabuar të dispozitave ligjore dhe në këtë mënyrë i kanë mohuar ankuesit të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm duke i cenuar edhe parimin e sigurisë juridike dhe mbrojtje ligjore.*

*Në rastin konkret është jo ligjore dhe jo e drejt që gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë nuk e marrin parasysh institutin e parashkrimit dhe pagesat e borxhit të kohëpaskohshme i konsiderojnë se kanë ndërprerë parashkrimin pasi që në këtë mënyrë i janë shkelur ankuesit të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Kosovës si dhe me KEDNJ dhe Deklaratën Universale.*

*Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës konsideron si të kundërligjshme të dy aktvendime të Gjykatës Themelore në Pejë dhe të Gjykatës së Apelit, për faktin se nuk kanë marrë parasysh institutin e parashkrimit 1 vjeçar sipas nenit 360 të LMD-së, dhe se në rastin konkret kemi të bëjmë me borxh dhe jo me këste, andaj pagimi i ndonjë muaji nuk paraqet as pranim borxhi dhe as ndërprerje të parashkrimit.*

*Gjykatat detyrohen përmes nenit 31 të Kushtetutës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm si dhe arsyetim të vendimit duke e respektuar edhe parimin e sigurisë juridike kurse këto gjykata e kanë refuzuar prapësimin dhe ankesën e debitorit duke vepruar në kundërshtim me Ligjin e Marrëdhënieve të Detyrimeve dhe Kushtetutën e Kosovës”.*

22. Parashtruesi i kërkesës *“[...] dëshiron që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës të konstatojë se me aktvendimet përfundimtare të Gjykatës Themelore Ep. nr. 714/19 të dt. 16.07.2020, [...] si dhe aktvendimin Ac. nr. 5936/20 i dt. 24.03.2021 të Gjykatës së Apelit, ka shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të ligjeve pozitive në vend, për gjykim të drejtë dhe të pa anshëm, e në mbrojtje gjyqësore të drejtave si dhe cenim të parimit të sigurisë juridike, në dëm të ankuesit, të cilit në mënyrë kundërligjore dhe në kundërshtim me praktikën e Gjykatës Evropiane”.*
23. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës dëshiron që Gjykata *“të bëjë edhe interpretimin e dispozitës ligjore të nenit 360 të LMD-së, që ka të bëjë me kërkesat që parashkruhen për 1 vit, kjo dispozitë ligjore a vlen për të gjitha subjektet fizike dhe juridike (pa marrë parasysh a janë subjekte afariste/tregtare, ndërmarrësi etj.) kur kemi të bëjmë me kërkesa që sipas LMD-së, parashkruhen për 1 vit”.*
24. Duke pasur parasysh të lartcekurat, parashtruesi në fund kërkon që të shpallet i pavlefshëm Aktvendimi i Gjykatës Themelore Ep. nr. 714/19 të 16 korrikut 2020, dhe ai



i Gjykatës së Apelit Ac. nr. 5936/20 të 24 marsit 2021 dhe çështja të kthehet në rivendosje.

## **Dispozitat relevante ligjore**

### **LIGJI NR. 04/L-077 PËR MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE**

#### **Neni 360**

#### **Afati njëvjeçar i parashkrimit**

*“1. Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti:*

*1.1. kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake;*

*1.2. kërkesat e radios dhe televizionit për përdorimin e stacionit;*

*1.3. kërkesat e postës dhe kompanive të telekomit për përdorimin e telefonit e të separateve postare, si dhe kërkesat e tjera të tyre që arkëtohen në afate tre (3) mujore apo më të shkurtra;*

*1.4. kërkesat e parapagimit në botime periodike, duke llogaritur nga kalimi i kohës për të cilën është porositur botimi;*

*1.5. kërkesat për shërbimet e qasjes në internet, shërbimet për përdorimin e e-mail-it, shërbimet për mirëmbajtjen e “faqes elektronike”, dhe shërbimet e lidhura me qasjen në stacionet e radios dhe televizionit kabllor dhe satelitor që arkëtohen në afate tre (3) mujore apo më të shkurtra;*

*1.6. kërkesat nga administratorët e blloqeve të apartamenteve për shërbimet dhe kërkesat e tjera që arkëtohen në afate tremujore apo më të shkurtra.*

*2. Afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë.*

*3. Parashkrimi rrjedh edhe nëse furnizimi dhe shërbimet vazhdojnë”.*

#### **NËNKREU 4**

#### **NDËRPRERJA E PARASHKRIMIT**

#### **Neni 368**

#### **Pranimi i borxhit**

*“1. Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin.*

*2. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”.*

#### **Neni 373**

#### **Afati i parashkrimit në rastin e ndërprerjes**

*“[...]*

*6. Parashkrimi që fillon të rrjedhë përsëri pas ndërprerjes, mbaron kur të ketë kaluar aq kohë sa është caktuar me ligj për parashkrimin që është ndërprerë”.*

## **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

25. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë, të specifikuara në Ligj dhe të parapara më tej në Rregullore të punës.

26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.  
[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

27. Gjykata më tej shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen në Ligj. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47  
[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individ mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48  
[Saktësimi i kërkesës]

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

Neni 49  
[Afatet]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.*

28. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata gjen se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin e Gjykatës së Apelit Ac. nr. 5936/20 të 24 marsit 2021, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës në një pjesë të kërkesës ka qartësuar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

29. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Paragrafi (2) i rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton kushtet në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë, duke përfshirë edhe kushtin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Konkretisht, rregulli 39 (2) parasheh se:

*“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*

30. Rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajtja e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës.
31. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih rastet e GJEDNJ-së *Kemmachev kundër Francës*, kërkesa nr. 17621/91, kategoria (i), *Mentzen kundër Lituanisë*, kërkesa nr. 71074/01, kategoria (ii) dhe *Trofimchuk kundër Ukrainës*, kërkesa nr. 4241/03, kategoria (iii)).
32. Në këtë kontekst dhe në vazhdim, për të vlerësuar pranueshmërinë e kërkesës, përkatësisht, për të vlerësuar në rrethanat e këtij rasti, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht, do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
33. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata rikujton se thelbi i rastit të parashtruesit të kërkesës bazohet në faktin se KESCO ka paraqitur para përmblyesit privat propozim për përmblyerim kundër parashtruesit të kërkesës, për shkak të arkëtimit të borxhit në shumë prej 355.02 euro, të krijuar si rezultat i shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën kohore nga data 3 prill 2014 deri më 10 tetor 2018. Parashtruesi i kërkesës konsideroi se një pjesë e borxhit të tij ishte parashkruar duke pasur parasysh dispozitën ligjore të nenit 360 të LMD-së dhe rrjedhimisht, paraqiti propozim në Gjykatën Themelore. Gjykata Themelore përmes Aktvendimit refuzoi propozimin e parashtruesit të kërkesës në bazë të dispozitave ligjore të nenit 368 paragrafët 1 dhe 2 dhe nenit 373 paragrafi 6 të LMD-së, duke konsideruar se vetë fakti se parashtruesi i kërkesës “ka bërë pagesa të kohëpaskohshme” ndikoi në ndërprerjen e parashkrimit. Kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, ndërsa kjo e fundit e refuzoi ankesën si të pabazuar.
34. Bazuar pikërisht në përmbledhjen e fakteve, Gjykata gjen se parashtruesi i kërkesës konsideron se me aktvendimet e Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit, janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 24, 31 dhe 54 të Kushtetutës, nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe me nenet 7 dhe 10 të Deklaratës Universale, në atë mënyrë që këto gjykata kanë interpretuar dhe zbatuar gabimisht dispozitën përkatëse ligjore të nenit 360 të LMD-së në lidhje me institutin e parashkrimit.



35. Mirëpo, përkundër faktit se parashtruesi i kërkesës theksoi shkelje të një numri më të madh të neneve, ai nuk i arsyetoi ato një nga një, në atë mënyrë që këto pretendime të kërkonin një analizë individuale. Në fakt, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës i ndërlidh të gjitha pretendimet për shkelje të neneve të Kushtetutës, KEDNJ-së dhe Deklaratës Universale me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike si dhe me interpretimin dhe zbatimin e gabuar të nenit 360 të LMD-së nga Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit, gjë që hyn në fushën e drejtësisë së procedurës nga neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe nga neni 10 i Deklaratës Universale.
36. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh se parashtruesi, në kërkesën e tij, i ndërton pretendimet për shkelje të neneve në fjalë mbi vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, si dhe mbi zbatimin arbitrar të së drejtës materiale, gjë që, sipas pretendimeve të tij, ka vënë në pikëpyetje drejtësinë e procedurës, Gjykata rikujton se, sipas praktikës së GJEDNJ-së dhe të Gjykatës Kushtetuese, detyrë e këtyre gjykatave nuk është të rishqyrtojnë gjetjet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës (shih, GJEDNJ, *Pronina kundër Rusisë*, Vendim për pranueshmëri i 30 qershorit 2005, kërkesa numër 65167/01). Në të vërtetë, Gjykata Kushtetuese nuk është kompetente që t'i zëvendësojë gjykatat e rregullta në vlerësimin e fakteve dhe provave, por, është detyrë e gjykatave të rregullta që t'i vlerësojnë faktet dhe provat të cilat i kanë administruar (shih, Gjykata Evropiane, *Thomas kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aktgjykim i 10 majit 2005, kërkesa numër 19354/02). Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është që të shqyrtojë nëse, eventualisht, ka ardhur deri te shkelja apo shpërfillja e të drejtave kushtetuese (e drejta për gjykim të drejtë, e drejta për qasje në gjykatë, e drejta për mjete efektive juridike, etj.), si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar apo diskriminues.
37. Duke shqyrtuar me vëmendje pikërisht pretendimet e parashtruesit të kërkesës për zbatimin dhe interpretimin e gabuar të nenit 360 të LMD-së nga Gjykata Themelore në kontekst të drejtësisë së procedurës, Gjykata vëren se dispozita ligjore e nenit 360 të LMD-së është zbatuar nga Gjykata Themelore në lidhje me nenin 368 paragrafët 1 dhe 2, si dhe me nenin 373 paragrafin 6 të LMD-së, dhe me këtë rast ajo nxori përfundimin si në vazhdim. Sa i përket zbatimit të nenit 360 të LMD-së, Gjykata Themelore ka qenë e mendimit se ky nen nuk është i zbatueshëm në rastin konkret duke marrë parasysh faktin se parashtruesi i kërkesës ka bërë pagesa të veçanta për borxhin e arritur në secilin prej viteve të pretenduara, gjë që kishte vërtetuar në bazë të dëshmive të pagesave. Veprimet e tilla të parashtruesit të kërkesës "[...] kanë ndikuar që të vijë deri të ndërprerja e parashkrimit dhe rrjedhimisht edhe pranimi të borxhit nga ana e debitorit" dhe rrjedhimisht deri te zbatimi i dispozitës ligjore të nenit 368 paragrafët 1 dhe 2 të LMD-s i cili rregullon çështjen e ndërprerjes së parashkrimit, si dhe deri te zbatimi i nenit 373 paragrafi 6 të LMD-së i cili parashikon se kur fillon të llogaritet përsëri parashkrimi.
38. Në bazë të kësaj rezulton se Gjykata Themelore konkludoi se vetë veprimi i parashtruesit të kërkesës, që u manifestua përmes pagesave të veçanta monetare për borxhin e arritur, krijoi një situatë juridike se ai në mënyrë të tërthortë ka pranuar ekzistimin e borxhit ndaj kreditorit (KESCO), duke ndërprerë kështu afatin e parashkrimit i cili ishte duke rrjedhur, gjë që rezultoi me zbatimin e dispozitës së re ligjore të nenit 373 paragrafi 6 të LMD-së, i cili parashikon një rregull të përgjithshëm sipas të cilit parashkrimi që fillon të rrjedhë përsëri pas ndërprerjes, mbaron kur të ketë kaluar aq kohë sa është caktuar me ligj për parashkrimin që është ndërprerë.
39. Gjykata më tej gjen se Gjykata e Apelit i adresoi edhe pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës lidhur me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe

interpretimin dhe zbatimin e gabuar të nenit 360 të LMD-së, lidhur me interpretimin e nocionit të parashkrimit, duke konkluduar se:

*“[...] nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit lidhur me gjendjen faktike si dhe ato për parashkrimin e borxhit, për faktin se sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit...”*

*“[...] pagesa të bëra nga ana e debitorit e ndërpresin afatin e parashkrimit në kuptim të dispozitës së lartcekur (të nenit 368 par. 1 dhe 2 të LMD-së) dhe rrjedhimisht edhe pranimin e borxhit ndaj kreditorit, andaj qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë mbi refuzimin e prapësimit të debitorit është i drejtë dhe i ligjshëm, ndërsa pretendimet ankimore të debitorit lidhur me parashkrimin e borxhit rezultojnë si të pathemelta, të cilat kjo gjykatë i refuzoi si të pabazuara, ndërsa aktvendimin e atakuar vendosi që ta vërtetojë”.*

40. Për më tepër, Gjykata nuk mund të mos vërejë se Gjykata e Apelit i adresoi edhe pretendimet tjera ankimore të parashtruesit të kërkesës, por ato, sipas gjetjeve dhe përfundimit të saj, nuk kanë qenë të rëndësishme vendimtare për të vendosur ndryshe nga ajo që ka vendosur gjykata e shkallës së parë, pasi që nga shkresat e lëndës është vërtetuar bindshëm se debitori ka bërë shpenzimin e energjisë elektrike gjatë periudhës për të cilin kreditori e ka kërkuar borxhin dhe se rrjedhimisht ekziston detyrimi i debitorit që ta përmbushë borxhin.
41. Në bazë të lartcekurave, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës se neni 31 i Kushtetutës, neni 6 i KEDNJ-së, si dhe neni 10 i Deklaratës Universale, janë shkelur si rrjedhojë e interpretimit dhe zbatimit të gabuar të nenit 360 të LMD-së nga Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit, kualifikohen si (i) pretendime “të shkallës së katërt”, sepse ngërthejnë çështje që ndërlidhen me vërtetimin e gjendjes faktike dhe interpretimin dhe zbatimin e ligjit, përkatësisht me “ligjshmërinë” dhe jo me “kushtetutshmërinë”.
42. Prandaj, dhe bazuar në sqarimet e mësipërme, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështet në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij për zbatim të gabuar të ligjit nga gjykatat e rregullta dhe, rrjedhimisht, këto pretendime janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese ashtu siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
43. Gjykata rikujton gjithashtu se parashtruesi në kërkesën e tij, ndër të tjera, pretendon edhe shkeljet e nenit 24 dhe nenit 54 të Kushtetutës, si dhe nenit 7 të Deklaratës Universale, pa shpjeguar dhe pa arsyetuar mbi të cilat pretendime ai i ndërton këto shkelje.
44. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata rikujton se sipas praktikës së themeluar gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata e shpall kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar në pajtim me kriterin (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara” kur plotësohet një nga dy kushtet karakteristike, përkatësisht:

a) kur parashtruesi thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (shih: në këtë drejtim, rastin e GJEDNJ-së *Trofimchuk kundër Ukrainës* (Vendim) nr. 4241/03, të 31 majit 2005, shih, gjithashtu, rastin *Baillard kundër Francës* (Vendim) nr. 6032/04, të 25 shtatorit 2008);

b) kur parashtruesi nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat do t'i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë ta bëjë këtë (për shembull, nëse autoritetet e burgut refuzojnë të paraqesin në Gjykatë dokumentet nga shkresat e lëndës së të burgosurit për të cilin bëhet fjalë) ose nëse vetë Gjykata nuk vendos ndryshe (shih rastin KI166/20, parashtrues *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 janarit 2021, paragrafi 42).

45. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës vetëm i përmend shkeljet e neneve 24 dhe 54 të Kushtetutës, si dhe të nenit 7 të Deklaratës Universale, por në kërkesën e tij nuk ofron ndonjë arsyetim më të detajuar se si ka ardhur deri te shkelja e këtyre neneve. Lidhur me këto pretendime, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës vetëm i përmend nenet përkatëse, por nuk shtjellon më tutje se si dhe përse ka ardhur deri te shkelja e këtyre neneve përkatëse të Kushtetutës. Gjykata rikujton se ajo ka theksuar vazhdimisht se vetëm referimi i neneve të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së dhe përmendja e tyre nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet KI175/20, cituar më lart, paragrafi 81, KI166/20, cituar më lart, paragrafi 52, KIO4/21, cituar më lart, paragrafët 38-39).
46. Andaj, Gjykata konstaton se sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenet 24 dhe 54 të Kushtetutës, si dhe me nenin 7 të Deklaratës Universale, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar pasi këto pretendime kualifikohen si pretendime që i takojnë kategorisë (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara” sepse parashtruesi i kërkesës thjesht citoi një ose disa dispozita të Konventës apo Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur. Rrjedhimisht, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113. 1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 8 qershor 2022, njëzëri

## VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TUA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**



Nexhmi Rexhepi



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**



Gresa Caka-Nimani